



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2022

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga gazetari i Televizionit Neës24

Znj. Fatmira Nikolli

Email- fatmiranikolli@gmail.com

Adresa: Uzina e Autotraktorave

TIRANË

E nderuar znj. Nikolli,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 1295 (tonën) prot. datë 28.07.2022, dërguar me email Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) për informacion, dhe pyetjet e ngritura, ju informojmë si më poshtë:

Së pari baza ligjore si edhe objekti kërkesës tuaj për informacion, lidhet me ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, por i nënshtrohet kryesisht dhe rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligjvënësi kur hartoi ligjin 45/2015, e pajisi institucionin e Autoritetit me kompetenca të plota për të kryer detyrën funksionale dhe për t’i shërbyer secilit kërkues (institucion, individ, studiues/media), duke pasur parasysh që, në secilën vendimarrje të Autoritetit të mbrojtë interesat e individit/individëve, interesat e shtetit (Siguri Kombëtare) si dhe interesat publike.

Pyetja 1 Si nisi kërkimi për shtetasin I.M. referuar njoftimit të institucionit tuaj të datës 26 korrik?

Përgjigje- Autoriteti u vu në dijeni nëpërmjet postës elektronike në të cilin pretendohet/denoncohet se ka dijeni se shtetasi I. M. ka dhënë informata në ngarkim të F. T. Ky informacion gjendet në dosjen e këtij shtetasi. U konstatua se dosja në emër të F.T. e përmendur edhe në kërkesën e paraqitur ekziston.

Referuar dispozitës të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar parashikohet “Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i janë vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i certifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar. Në zbatim të kësaj dispozite, Autoriteti nuk ka kryer verifikim për I.M. Sa më sipër, çdo subjekti i përmendur në njoftimin zyrtar gëzon mbrojtjen ligjore të

dispozitave të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar. Ligji nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, në nenin 16 të tij parashikon se “Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ***ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025*** (me përjashtim të institucioneve përgjegjëse të ngarkuara nga ligji).

Lidhur me pyetjet e tjera për të cilat kërkohet informacion;

Ligji organik nr. 45.2015 që normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posacëm, gjen zbatim duke preluar mbi ligjin nr. 119.2014 i cili zbatohet për aq sa është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi informacioni që kërkohet për vënie në dispozicion është dokumentacion arkivor.

Pra kërkesa juaj për informim i nënshtrohet dispozitave procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkuesve që mund të kenë qasje në informacion, objektin, qëllimin e përdorimit të informacionit, të drejtat e kërkuesve mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve si dhe kriteret e përdorimit të informacionit.

Sipas Nenit 20 të ligjit nr. 45/2015

Garantimi i së drejtës për informim

1. Kërkuesit i njihet e drejta për t’u njohur me dokumentet ***kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit*** të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me procure i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre.

Sa më sipër çdo individ në cilësinë e kërkuesit ka mundësi të aplikojë për informacion në Autoritet, për veten e tij ose të afërmit të tij brenda parashikimit të ligjit 45/2015 duke plotësuar formularin përkatës të miratuar nga Autoriteti.

Në Nenin 34 të ligjit nr. 45/2015 parashikohet se

“Informacionet që lidhen me persona, të marra në përputhje me parashikimet e këtij kreu, përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë kërkuar, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj”.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” në fushën e së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, konkretisht ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, informacionet që disponon Autoriteti qoftë për subjektin e verifikimit, qoftë për individin si kërkues në cilësinë e të prekurit përmbajnë të dhëna personale të subjekteve, personave të tjerë, të cilat gëzojnë ruajtje sipas legjislationit në fuqi, subjektit kërkues i shpjegohet se për të mbrojtur të drejtat e kërkuesit, ky informacion do të jetë konfidencial vetëm për atë dhe askënd tjetër dhe për këtë arsye nuk

mund t'i vendosen asnjë pale tjetër në dispozicion me përjashtim të institucioneve të përcaktuara nga ligji dhe kërkuesit si subjekt i këtij ligji.

Nisur nga rastet konkrete dhe problemarikat e ndeshura në vite, u informua dhe kërkua nga organi më i lartë, Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të veprohet për ndryshime të mëtejshme ligjore, dhe në këtë kuadër, Autoriteti ka paraqitur pranë Kuvendit edhe Vendimin nr. 321 datë 26.07.2022, me objekt miratimin e propozimeve të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 45/2015 i ndryshuar dhe në kodin zgjedhor.

Ligji nr. 45/2015 parashikon në nenin 38 **“Informimi i medias”** të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit ku përcaktohet.

1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.

2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratat kundërta të personave të përmendur, këto deklaratat u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese.

Bazuar në dispozitën e mësipërme të ligjit të posaçëm nr. 45/2015 lidhur me procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media mund të paraqisni kërkesën dhe formularin përkatës për studiues, media të miratuar nga Autoriteti. Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje.

Sa i takon pyetjes lidhur me materialet e deklasifikuara në afatin kohor të specifikuar në pyetje dhe a mund të vihen në dispozicion, informojmë se dokumentacioni arkivor i identifikuar sipas objektit të kërkesës për informim, është deklasifikuar nga Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleftësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” në Autoritet, do t'i dërgohet për njohje dhe përdorim DSIK si bibliografi dhe do të botohet në Fletoren Zyrtare, e më pas do të publikohet në faqen zyrtare të insitiucionit në zbatim të legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale nga ku mund të aksesohet.

Bashkëlidhur gjeni formularin për studiues/media të miratuar nga Autoriteti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Informacionit

Selami Zalli